

INSPEKTORATI SHITËTËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL						
Regjistri i Kërkesave/Ankesave dhe Përgjigjeve ISHTI JANAR 2026						
Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	13.01.2026	Kërkohej informacion mbi kushtet e sigurisë të bombolave të oksigjenit në ambiente publike. Do të donim një një përfaqësues nga ISHTI për një bisedë rreth kësaj teme.	14.01.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj lidhur me zhvillimin e intervistës mbi kushtet e sigurisë të bombolave të oksigjenit, konfirmojmë realizimin e intervistës me përfaqësues nga Drejtoria e Pajisjeve nën Presion në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial.	E plotë	0
2	14.01.2026	Kërkohej informacion lidhur me një ngjarje zjarrvënjeje të ndodhur, ku është djegur plotësisht objekti duke shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale. Për sa i përket veprimeve procedurale të ndërmarra pas ngjarjes, ju informoj se nuk është kryer asnjë lloj verifikimi teknik apo ekspertizë në vendngjarje. Megjithatë, shkaku i zjarrit i është referuar si "shkëndije elektrike", pa u mbështetur në një akt ekspertimi teknik të pavarur dhe të dokumentuar. Në këto kushte, duke qenë se përcaktimi i shkakut të zjarrit është thelbësor si për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes, ashtu edhe për vijimin e mëtejshëm të procedurave ligjore, kërkoj nga ana juaj caktimin e një eksperti teknik i cili të kryejë një ekspertizë të specializuar dhe të paanshme mbi shkaqet e zjarrit.	19.01.2026	Në përgjigje të e-mailit tuaj ardhur në adresën elektronike info@ishti.gov.al, lutemi bashkëlidhur gjeni linkun	E plotë	0
3	15.01.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me një raport testimi të leshuar nga institucioni juaj. Si pjesë e komisionit për një procedurë prokurimi kërkojmë konfirmim nëse raport testimi është i vlefshëm dhe pse nuk ka nënshkrimin e titullarit, dhe funksionin e vules se kuqe në fund.	16.01.2026	leshuar nga institucioni ynë, ju bëjmë me dije se: ky raport testim është i vlefshëm. Vlefshmërinë ja jep vula e kuqe në fletë, e cila vendoset nga zyra e protokollit të institucionit. Kjo vullë e certifikon kopjen e dokumentit (në rastin konkret të raport testimi), si një kopje të vërtetë dhe tregon që kopja përmban të dhëna të sakta mbi origjinalin dhe është e vlefshme për përdorim, sipas rregullave arkivore.	E plotë	0
4	20.01.2026	Kërkesë për kryerjen e akt-ekspertizës në banesën time, në zonën ku banoj ka patur ndërprerje të energji se elektrike dhe pas rikthimit të saj janë shkaktuar luhajtje të forta tensioni, si pasojë e të cilave është dëmtuar soba elektrike dhe është krijuar rrezik zjarri. Duke qenë se dëmi dyshohet se është shkaktuar nga furnizimi me energji elektrike, kërkoj: - Dërgimin e një grupi inspektimi nga ISHTI - Kryerjen e akt-ekspertizës teknike në vendngjarje - Hartimin e raportit zyrtar për shkakun e dëmit	23.01.2026	Dërguar kthim përgjigje lidhur me kërkesën për kryerjen e aktit të ekspertizës qyetetarit, shkresa i është dërguar edhe fizikisht në adresën vënë në dispozicion.	E plotë	0
5	21.01.2026	Kërkesë për informacion lidhur me analizën e bitumit.	21.01.2026	Ne vijim të e-mail tuaj ju bejme me dije se Drejtoria e Laboratorit Qendror, per lenden Bitum teston treguesit si me poshte vijojne: Temperatura e flakerimit me kroxhol te hapur sipas standardit S SH EN ISO 2592:2017 Penetracioni ne 25°C sipas standardit S SH EN 1426:2015 Per sa i perket tarifave te analizimit, ato paraqiten ne Urdhrin Nr.6, Date 09.01.2015 "Per kontrollin e standardeve teknike te naftes dhe nenprodukteve te saj, procedurat dhe tarifat perkatese", Aneksi Nr.1.	E plotë	0
6	27.01.2026	Në vijim të një procedure prokurimi edhe kundër ankesës tonë është shpallur fitues dhe me shume mundesi ka kryer furnizim nje subjekt i papajisur me licence tregtimi madje as nuk ka lidhje me furnizimin me karburante. Duke qene se ju jeni inspektoriati pergjegjes ju lutem te kryeni verifikimet perkatese sepse po ndodh shpesh qe subjekte te palicensuara kryejne furnizime me nenprodukte te naftes duke shkelur ligjin, nxitur konkurrence te pandershme dhe duke vene ne rrezik banoret apo ne rastin konkret nxenesit. Ju lutemi ti drejtoheni ketij autoriteti per verifikime te metejshme pasi ne na rezulton fitues një subjekt person fizik i palicensuar i cili kryer furnizime me nenprodukte te naftes duke shkelur ligji	30.01.2026	Me kërkesë për verifikim ligjshmërie ndërguar me email me datë 27.01.2026 protokolluar me Tonën me Nr. 1135 Prot., datë 27.01.2026 ku informon Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial se në vijim të një procedure prokurimi të kryer është shpallur fitues një subjekt i palicensuar dhe me shumë mundësi ka edhe furnizim me karburante. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, ushtron kontrollin në të gjitha subjektet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar; Ligjit nr 32/2016, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion", si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tyre. Në ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", neni 4, përcakton se, ushtrimi i veprimtarive në këtë fushë kryhet vetëm nga persona juridik pasi të jenë pajisur me licencat dhe autorizimet përkatëse. Për sa më sipër dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional kërkojmë të na informoni mbi subjektet sipas kërkesës së shoqërisë, që ISHTI të vijoj sipas përcaktimeve të dispozitave të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".	E plotë	0

